Kronikë

Tiranë/ Ktheu lokalin në bazë për shitjen e drogës dhe 'depo armësh', në kërkim pronari, arrestohet punëtori! (EMRI+VIDEO)

Policia e Tiranës bëri me dije se si rezultat i kontrolleve në kuadër të operacionit "Mix", janë goditur dy raste të armëmbajtjes pa leje dhe të përshtatjes së lokalit për përdorim e shitje të drogës

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
30 Mars, 10:09 | **Përditesimi: 30 Mars, 10:43**

Share

Tiranë- Kthyen lokalin në bazë për shitjen e drogës dhe mbajtjen e armëve pa leje, arrestohet punëtori, shpallet në kërkim pronari.

Policia e Tiranës bëri me dije se si rezultat i kontrolleve në kuadër të operacionit "Mix", janë goditur dy raste të armëmbajtjes pa leje dhe të përshtatjes së lokalit për përdorim e shitje të drogës.

Mësohet se pronari 26-vjeçar, Gentian Cenaj, akuzohet për përshtatjen e lokalit për aktivitet kriminal dhe punëtori për krimin e armëmbajtjes pa leje në këto ambiente.



LEXO EDHE:
Vrasja e Stiven Toshkesit pas sherrit për një vajzë, 18 vite burg për autorin

> *"Seksioni për Hetimin e Narkotikëve në DVP Tiranë, bazuar në informacionet e siguruara nga inteligjenca informative dhe në vijim të kontrolleve të ushtruara në ambiente të ndryshme për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje dhe narkotikëve, në kuadër të operacionit policor "Mix" arrestuan shtetasin L. T., 18 vjeç, si dhe shpallën në kërkim shtetasin G. C., 26 vjeç, të dy banues në Tiranë", njoftoi policia e kryeqytetit.*

Më tej sqaroi se nga kontrolli i lokalit, shërbimet gjetën dhe sekuestruan një armë zjarri pistoletë, municion luftarak, 3 krehër pistolete, 4 armë të ftohta dhe prova të tjera materiale.

> *"Vijon puna për kapjen e pronarit të lokalit dhe dokumentimin e plotë ligjor i kësaj veprimtarie kriminale. Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale", bëhet me dije për këtë aksion.*

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: Tirane | droge | arme zjarri | policia e shtetit | gentian cenaj

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 30 Mars, 00:06
Programi i PS, a ju duken të realizueshme objektivat ekonomikë?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Tiranë/ Sherr i dhunshëm, 3 persona dhunojnë fizikisht 39-vjeçarin, lëndohet një 29-vjeçar që ndërhyri
30 Mars, 14:47

Tiranë/ Eksperienca unike e makinave, ndahen çmimet e eventit të madh të automobilizmit
30 Mars, 13:19

Tiranë/ Po trafikonte mbi 8 kg hashash me makinë, 'Transportuesi' prangos 54-vjeçarin pas ndjekjes në Laprakë! Në banesë i gjendet edhe një çifte pa leje
30 Mars, 11:40

Politika uron besimtarët myslimanë për Fitër Bajramin, Begaj: Të jemi të bashkuar në shërbim të interesit kombëtar! Spiropali: Mbarësi e më shumë dashuri
30 Mars, 10:31

U fronëzua dje, Kryepeshkopi Joan mban në gjuhën shqipe meshën e parë në katedralen 'Ngjallja e Krishtit'
30 Mars, 09:24

Kremtohet Fitër Bajrami, mijëra besimtarë falen në 'Sheshin Skënderbej'! Spahiu: Lusim Zotin të na japë forcë të përballojmë sfidat e jetës! Unitet, mëshirë, drejtësi
30 Mars, 07:05

Zyrtare/ Sokol Haxhia është Drejtori Teknik i Partizanit, ish-futbollisti rikthehet në shtëpi
29 Mars, 21:45

Ngacmim seksual në Tiranë, 38-vjeçari merr në shtëpi 24-vjeçaren dhe më pas zhduket
29 Mars, 17:16

Meta audio mesazh nga qelia: Rama ka nisur të vjedhë premtimet elektorale të opozitës! 11 Maji, dita e fitores së lirisë mbi tiraninë
29 Mars, 15:52

Tritol lokalit në Tiranë më 25 mars/ Identifikohet e shpallet në kërkim 47-vjeçari, policia i gjen veshjet e përdorura ditën e ngjarjes dhe biçikletën me të cilën u largua (EMRI)
29 Mars, 13:52

Veliaj: Tirana, një qytet solidar me 8 qendra sociale për nevojtarët
29 Mars, 13:23

Tirana e dedikuar Motosportit, 'Automotive Fair Albania 3' sjell eksperinca unike! Pilotët: Aktivitete të tilla kishin munguar (VIDEO)

Ernest Koçi

29 Mars, 11:12

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje